



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA  
(ADISA)

**RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE  
NË USHTRIMIN E DETYRAVE FUNKSIONALE NË  
AGJENCINË E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTERGUARA  
(ADISA)**

Miratuar me Vendim Nr.3, datë 25.04.2017 të Këshillit Drejtues  
(*Ndryshuar me vendimin nr. 8, datë 05.11.2019 të Këshillit Drejtues*)

## Tabela e përmbajtjes

<b>KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b> .....	3
Neni 1 Qëllimi dhe objekti.....	3
Neni 2 Baza ligjore .....	3
Neni 3 Përkufizime .....	3
Neni 4 Fusha e zbatimit .....	4
<b>KREU II DISPOZITA TË VEÇANTA</b> .....	4
Neni 5 Vendimmarrja .....	4
Neni 6 Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt.....	5
Neni 7 Interesat private të zyrtarit .....	6
Neni 8 Deklarimi i interesave privatë të zyrtarit.....	7
Neni 9 Identifikimi i interesave privatë nga të tretë .....	7
Neni 10 Lëshimi i autorizimit .....	8
Neni 11 Strukturat Përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit.....	8
Neni 12 Detyrat e Autoritetit Përgjegjës.....	8
Neni 13 Regjistri i konflikteve të interesave.....	9
Neni 14 Regjistrimet e rasteve të konflikteve të interesit .....	9
Neni 15 Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave privatë .....	10
Neni 16 Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit të interesit për çështje të veçanta .....	10
Neni 17 Ndalimi i marrjes së dhuratave .....	10
Neni 18 Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin .....	11
Neni 19 Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave .....	12
Neni 20 Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës .....	12
Neni 21 Hyrja në fuqi .....	12

# KREU I

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Qëllimi dhe objekti

- 1.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është sigurimi dhe garantimi i një procesi vendimmarrës të paanshëm dhe transparent, gjatë ushtrimit të detyrave funksionale nga zyrtarët e ADISA, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave publikë dhe privatë.
- 1.2 Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, përgjegjësive dhe detyrave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave në ADISA.
- 1.3 Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga kjo rregullore, do të zbatohen përcaktimet e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

### Neni 2

#### Baza ligjore

- 2.1 Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit në ADISA, bazohet në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar), Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 714, datë 22.10.2004 “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

### Neni 3

#### Përkufizime

*(Ndryshuar pika 3.5, me vendimin nr. 8, datë 05.11.2019 të Këshillit Drejtues)*

- 3.1 “**ADISA**” është Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.
- 3.2 “**Konflikt interesi**” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta apo të tërthorta të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.
- 3.3 “**Zyrtar**” është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në ADISA.
- 3.4 “**Eprorët e zyrtarëve**” në ADISA, sipas hierarkisë, brenda Agjencisë janë: Drejtor Ekzekutiv, Drejtor Drejtorie, Përgjegjës Sektori.

- 3.5 **“Institucion epror”** për ADISA-n është anëtari i Këshillit të Ministrave, i cili ka në fushën e përgjegjësisë së tij shërbimet publike.
- 3.6 **“Person i lidhur me një zyrtar”** të ADISA është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin sipas përcaktimit të pikës 11, të nenit 3 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005.
- 3.7 **“Parim i proporcionalitetit”** sipas nenit 46 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, (i ndryshuar), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësisë dhe kompetencave të një zyrtari të ADISA, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

#### **Neni 4** **Fusha e zbatimit**

- 4.1 Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t’u zbatuar nga:
- a) Çdo zyrtar i ADISA, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi apo kryen detyra dhe kompetenca të caktuara, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore sipas të cilave ushtron veprimtarinë e saj ADISA.
  - b) Çdo zyrtar i ADISA, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative, kontrata që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, në të cilat ADISA është palë;
  - c) Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në Kodin të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

## **KREU II** **DISPOZITA TË VEÇANTA**

#### **Neni 5** **Vendimmarrja**

- 5.1 Vendimmarrja për një akt apo procedim administrativ do të vlerësohet në çdo rast:
- a) çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit (urdhër, vendim, kontratë, marrëveshje);
  - b) çastet paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të këtij neni, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në të mëposhtmet:
    - i) hartimi i projektaktit nga zyrtari dhe dorëzimi i tij organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;

- ii) dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, për projektaktin nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
- iii) dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
- iv) dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
- v) përfshirja e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë e ADISA, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projekt aktit ose projekt-kontratës në tërësinë e tyre;
- vi) çdo rast tjetër në përputhje me kompetencat dhe të misionin e ADISA.

## **Neni 6**

### **Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt**

- 6.1 Një zyrtar i ADISA ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
- 6.2 Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
  - a. roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
  - b. zotërimi i informacionit, që lidhet me detyrën funksionale, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikën ekonomike dhe administrimin financiar;
  - c. çdo shkak tjetër në përputhje me objektivat strategjike, misionin dhe vizionin e ADISA lidhur me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të ADISA.
- 6.3 Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencës thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i ADISA, i emëruar nga Drejtori Ekzekutiv.

- 6.4 Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të Nenit 7 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë vendosjen në situata/raste të parashikuar si konflikt interesi të çfarëdo lloji.
- 6.5 Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pikës 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
- 6.6 Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas Nenit 37 të Ligjit Nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.

## **Neni 7**

### **Interesat private të zyrtarit**

- 7.1 Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, përkatësisht:
- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
  - b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
  - c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
  - d) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
  - e) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
  - f) marrëdhënie familjare apo të bashkëjetesës, të komunitetit, etnike, fetare, të njohura të miqësisë apo të armiçësisë;
  - g) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.
- 7.2 Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, që mund të jenë të përcaktuara në ligje të tjera të posaçme, sipas parimit “*zbatohet ai kufizim që është më i rreptë*”.
- 7.3 Nëse në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet

edhe për kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe anasjelltas.

- 7.4 Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit, i përcaktuar në Nenin 5 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3, të ligjit të lartpërmendur.

## **Neni 8**

### **Deklarimi i interesave privatë të zyrtarit**

- 8.1 Çdo zyrtar i ADISA, sipas përcaktimit të këtij termi, parashikuar në pikën 3.3 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, i cili përgatit raportet për kontroll të plotë në verifikimin e deklaratave të interesave private periodike të subjekteve të ADISA, mbikëqyr ose përdor fonde publike, lidh kontrata shërbimi, investimi, përfaqëson ADISA-n në marrëdhënie me të tretët, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tyre funksionale ose të ngarkuara përkohësisht, detyrohet të bëjë vetë deklaramin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat, që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit.
- 8.2 Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga eprorët e zyrtarët e përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje, kur kjo kërkohet nga Drejtori Ekzekutiv.
- 8.3 Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
- 8.4 Vetë deklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt dhe/ose për subjekte të deklaramin periodik të interesave private në ADISA.
- 8.5 Drejtori Ekzekutiv, me mbështetjen e Drejtorisë së Administrimit të Brendshëm dhe në bazë të vetë deklaramin të zyrtarit të ADISA, si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmangë emërimin e një zyrtari në pozicione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash. Drejtori Ekzekutiv merr masa që zyrtarit të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konfliktit të mundshëm interesash dhe në rast të kundërt merr masa për largimin e zyrtarit nga detyra.

## **Neni 9**

### **Identifikimi i interesave privatë nga të tretë**

- 9.1 Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit në ADISA, është:
- a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijani;
  - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijani dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

- 9.2 Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari dhe punonjësi të ADISA-s, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në Nenin 9 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

## **Neni 10**

### **Lëshimi i autorizimit**

- 10.1 ADISA vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit (në formë dhe përmbajtje), i cili duhet të jetë në përputhje me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale.
- 10.2 Çdo zyrtar brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës është i detyruar të lëshojë autorizimin në favor të ADISA.
- 10.3 Në rastin e autoritetit përgjegjës, autorizimi i lëshuar prej tij i vihet në dispozicion Drejtorit Ekzekutiv.
- 10.4 Për moslëshim autorizimi, sipas pikës 10.2 të këtij neni, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- 10.5 Mosdhënia e autorizimit brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit të parashikuar në pikën 10.2 të këtij neni, përbën shkak ligjor për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas legjislacionit përkatës.

## **Neni 11**

### **Strukturat Përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit**

- 11.1 Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji sipas hierarkisë në ADISA, janë:
- a) Drejtori Ekzekutiv;
  - b) Autoriteti Përgjegjës.

## **Neni 12**

### **Detyrat e Autoritetit Përgjegjës**

- 12.1 Autoriteti Përgjegjës në ADISA kryen detyrat e mëposhtme:
- a. njofton me shkrim zyrtarët e institucionit që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë;
  - b. mbledh deklaratat e zyrtarëve të institucionit që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe i dorëzojnë në ILDKPKI brenda afateve ligjore;
  - c. shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për tu lëshuar nga zyrtarët sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;



- d. njofton ILDKPI për ndryshimet e zyrtarëve-subjekte të deklarimit të pasurisë;
- e. krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit të evidentuara në ADISA.
- f. bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave privatë të zyrtarëve të institucionit, u sugjeron atyre dhe eprorëve të tyre momentet apo rastet kur duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
  - i. konfliktit rast pas rasti (faktik në dukje dhe të mundshëm);
  - ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit.
- g. mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, duke iniciuar masë disiplinore apo vendosje gjobe në rast kundërvajtjesh administrative, parashikuar nga Neni 44 i Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- h. informon zyrtarët e ADISA në lidhje me të drejtat e detyrimit e tyre të parashikuara nga Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- j. këshillohet si dhe merr informacionet e nevojshme në mënyrë të vazhdueshme pranë ILDKPKI për zbatimin e Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- i. ndjek dhe zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të Drejtorit Ekzekutiv.

### **Neni 13**

#### **Regjistri i konflikteve të interesave**

- 13.1 Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të ADISA, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
- 13.2 Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga Autoriteti Përgjegjës në ADISA.

### **Neni 14**

#### **Regjistrimet e rasteve të konflikteve të interesit**

- 14.1 Autoriteti përgjegjës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të ADISA, interesat privatë të tij, shkak për konfliktin e interesit, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët ose nga gjykatat.

**Neni 15**  
**Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram**  
**periodik të interesave privatë**

- 15.1 Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të ADISA bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
- 15.2 Zyrtarët e ADISA, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklaram të interesave private periodike janë:
- a) Drejtori Ekzekutiv.
- 15.3 Gjithashtu, në zbatim të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003, mbartin detyrim për deklaram të interesave private periodike bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të lartpërmendur të ADISA, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.
- 15.4 Çdo zyrtar i ADISA, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni, kalim në pozicion që nuk mbart detyrimin për deklaram, në rast se nuk është më subjekt i deklaramit të interesave private periodike në ILDKP, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar “Deklaratë pas largimit nga funksioni”. Me përmbushjen e këtij detyrimi Sektori i Burimeve Njerëzore i dorëzon zyrtarit Librezën e Punës dhe Librezën e Kontributeve Shoqërore dhe Shëndetësore.

**Neni 16**  
**Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit**  
**të interesit për çështje të veçanta**

- 16.1 Drejtori Ekzekutiv i ADISA:
- a. nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik;
- b. nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- c. nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.
- 16.2 Pjesa tjetër e zyrtarëve të ADISA nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër e cila bëhet pengesë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisive funksionale të tyre apo krijon apo duket sikur krijon një konflikt interesash me pozicionin e tij zyrtar.

**Neni 17**  
**Ndalimi i marrjes së dhuratave**

- 17.1 Është e ndaluar që një zyrtar në ADISA të kërkojë ose marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore,

premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në institucion, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklarimit të interesave private periodike në ILDKPKI, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji që ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës.

- a) “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 dhe në VKM Nr. 714, datë 22.10.2004;
  - b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.
- 17.2 Zyrtari nuk duhet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për dhënien e tyre për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij. Ai nuk duhet të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
- 17.3 Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.
- 17.4 Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM Nr. 714, datë 22.10.2004;
- 17.5 Në asnjë rast zyrtari i ADISA nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
- 17.6 Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

## **Neni 18**

### **Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin**

- 18.1 Person i lidhur me zyrtarin e ADISA, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 16 e 17 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:
- a. bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
  - b. çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
- 18.2 Personi i lidhur me zyrtarin e ADISA, nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritët me sferën e juridiksionit të zyrtarit të ADISA dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga

ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm:

- a. veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

### **Neni 19**

#### **Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave**

- 19.1 Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/punonjësit e ADISA bëhen sipas kreut IV të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

### **Neni 20**

#### **Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës**

- 20.1 Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të ADISA, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.
- 20.2 Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

### **Neni 21**

#### **Hyrja në fuqi**

- 21.1 Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin nga Këshilli Drejtues i ADISA.
- 21.2 Çdo ndryshim, shtesë apo shfuqizim i dispozitave të kësaj rregulloreje bëhet me miratimin e saj nga Këshilli Drejtues i ADISA.